



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Nr. 1263/12 Prot. datë 16.3.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr. 5195/11 Prot. datë 26.4.2023

U D H Ë Z I M

Nr. 8, datë 16.3.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 32, DATË 23.12.2022 "PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE DHE TË MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2023"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 51 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 7 dhe nenit 8, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",

U D H Ë Z O J M Ë:

1. Pika 15, në kreun I "Matura Shtetërore", të udhëzimit nr. 32, datë 23.12.2022 "Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2023", ndryshon si më poshtë:

"15. Testi i provimit "Gjuhë dhe letërsi italiane" (Lingua e literatura italiana) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe dorëzohet në QSHA në afatin kohor të përcaktuar për këtë provim. Ky provim zhvillohet në datën 01 qershor 2023 dhe zëvendëson provimin e gjuhës së huaj (D3) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane. Në notën e provimit përfshihet, siç është parashikuar në Memorandum, edhe vlerësimi i zhvilluar në shkollë në datën 29 maj 2023 para një komisioni të ngritur nga palët."

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit (MAS),

zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), Sekretari i Përgjithshëm i MAS, Sekretari i Përgjithshëm i MFE, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Arsimore Vendore Parauniversitare, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional në MFE, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

MINISTËR
EVIS KÛSHI



MINISTËR

DELINA IBRAHIMAJ

